

Kontratë Dhurimi të Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë

Sot me date 08.04.2024 palët e mëposhtme :

DHURUES:

Z. Massimo Corigliano , Shtetas Italian, i lindur më date 28.06.1960 në Roma (RM), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA25307KZ , në cilësinë e ortakut të shoqërisë "Dental Production" shpk, regjistruar si person juridik ne QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numer unik identifikimi te subjektit NUIS M41401513E , me adresë *Lagja Nr.4, Rruga Skenderbej, Pallati 6 katesh mbi Oshee, Durres (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si Dhuruesi).*

Dhe

PRANUES I DHURIMIT:

Z. Savino Cefola, Shtetas Italian, i lindur më date 11.03.1953 në Barletta (BA), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identiteti CA63522MO, (*Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Perfituesi i Dhurimit"*).

- **Objekti:** Dhurim i pjeses totale te kuotave te kapitalit te Ortakut Z.Massimo Corigliano të subjektit "Dental Production" sh.p.k

Baza ligjore : Neni Nr.659,761 e vijues i Kodit Civil, Ligji Nr 9723 date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ligji 9901 date 14.04.2008, "per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar , ligji 129/2014 per shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar .

Kushtet e Dhurimit

- Subjekti "Dental Production" sh.p.k është i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numer Nipti M41401513E.
- Pala dhuruese z.Massimo Corigliano është ortak i shoqërisë "Dental Production" sh.p.k me 1 kuotë me vlerën 1000 (një mijë) Lekë ose 10% (dhjetë) përqind te kapitalit themeltar, i cili dhuron 100% te kuotave te tij prej 1000 (një mijë) Lekë dhe me vullnetin e tij te lirë ka rënë dakort për ti dhuruar këto kuota ortakut të tij z.Savino Cefola .
- Pranuesi i dhurimit Z. Savino Cefola ka renë dakort dhe pranon dhurimin e një pjese prej 10% te kuotave te kapitalit te ortakut z.Massimo Coriglianote Shoqerisë "Dental Production" sh.p.k me vlere monetare prej 1000 (një mijë) Lekë.

Të drejtat e Dhuruesit

- Dhuruesi i bën të ditur pranuesit të dhurimit te gjithë dokumentacionin ligjor te subjektit.
- Dhuruesi garanton se dokumentacioni i subjektit është ligjor dhe subjekti është aktiv.

Të drejtat e pranuesit të dhurimit

- Pranuesi i Dhurimit behet zotërues i kuotave te dhuruara te kapitalit te Shoqerisë . Pas transferimit të kuotave , Dhuruesi nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto kuota dhe pranuesi i dhurimit te cilit i janë transferuar kuotat , ka të drejtë ti zotëroj , posedojë, përdor, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë .

Dispozita përfundimtare

Pas transferimit të kuotave , Dhuruesi nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto kuota dhe pranuesi i dhurimit te cilit i janë transferuar kuotat , ka të drejtë ti zotëroj , posedojë, përdor, shfrytëzojë dhe

rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë .

Pas ketij vendimi ndarja e kuotave te shoqërisë “Dental Production” shpk sipas ortakëve do të jetë si më poshtë :

Z.Savino Cefola 1 kuotë,me vlerën 1000 Lekë, zotëron 10% (njëzetë) përqind.

Z.Aurelio Marulli, 1 kuotë,me vlerën 1667 Lekë, zotëron 16.67% (gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) përqind.

Z.Giuseppe Esposito ,1 kuotë,me vlerën 1666 Lekë, zotëron 16.66% (gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë)përqind.

Z.Giovanni Curato , 1 kuotë,me vlerën 1667 Lekë, zotëron 16.67% (gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë)përqind.

Z. Giovanni Cefola, 1 kuotë,me vlerën 1000 Lekë, zotëron 10% (dhjetë) përqind.

Z.Illir Hoxhallari, 1 kuotë,me vlerën 3000 Lekë, zotëron 30% (tridhjetë)përqind.

Pjesët përbërese të kontratës

Pjesët përbërese të kësaj kontrate janë “ ekstrakti i shoqërisë, fotokopjet e mjeteve identifikuese, vendimi i ortakut.

Regjistrimi në QKB

Organi kompetent bën regjistrimin sipas vendimit të ortakut të shoqërisë “Dental Production” SH.P.K dhe kontratës së dhurimit ne emër dhe për llogari të Z.Savino Cefola i cili do të jetë ortak në këtë shoqëri me 10% te kuotave te kapitalit .

Kontrata pasi u lexua nga palët , u konstatua se ishte konform vullnetit të tyre kontraktor dhe me vullnetin e tyre të lirë nënshkruan .

PALËT

DHURUESI

Z.Massimo Corigliano

PRANUESI I DHURIMIT

Z.Savino Cefola